



# Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale  
Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës,  
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797  
Mail: [info@aab-edu.net](mailto:info@aab-edu.net);  
[www.aab-edu.net](http://www.aab-edu.net)

---


Ref. nr. 282/2021 Prishtinë, 20.05.2021

---

**RREGULLORE**  
**PËR**  
**RAPORTIN MBI REZULTATET E PROVIMIT**

--

--

Aprovuar nga:	Këshilli Drejtues i Kolegjit AAB Kryetari i Këshillit Drejtues 
---------------	---



Data e Miratimit:	20.05.2021
-------------------	------------

Ref. Nr.	28212021
----------	----------

Në bazë të nenit 33 të Statutit të Kolegjit AAB (në tekstin ë mëtejshëm AAB), Këshilli Drejtues miraton këtë rregullore.

## **RREGULLORE PËR RAPORTIN MBI REZULTATET E PROVIMIT**

### **Neni 1**

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e formatit dhe procedurën e verifikimit të raportit mbi rezultatet e provimit.

### **Neni 2**

Raporti mbi rezultatet e provimit përbëhet prej dy pjesëve dhe atë:

1. Raporti mbi rezultatet e vlerësimit të studentëve dhe
2. Lista e studentëve të paraqitur në provim

### **Neni 3**

1. Raporti mbi rezultatet e vlerësimit të studentëve përmban shënime rreth lëndës dhe të dhëna statistikore rreth rezultateve të vlerësimit dhe duhet të jetë në harmoni me listën e studentëve të paraqitur në provim.
2. Raporti mbi rezultatet e vlerësimit të studentëve plotësohet nga profesori i lëndës dhe dorëzohet në administratën e fakultetit dhe duhet të nënshkruhet nga:
  - a. Profesori i lëndës
  - b. Asistenti administrativ i fakultetit dhe
  - c. Dekani i fakultetit
3. Raporti mbi rezultatet e vlerësimit të studentëve duhet të përmbajë këto shënime:
  - a. Fakultetin
  - b. Programin e studimit
  - c. Afatin e provimeve
  - d. Viti akademik
  - e. Datën e mbajtjes së provimeve
  - f. Emërtimin e lëndës
  - g. Emrin dhe mbiemrin e mësimdhënësit
  - h. Kreditë e lëndës (ECTS)
  - i. Numrin e përgjithshëm të studentëve të paraqitur
  - j. Rezultatet e vlerësimit
  - k. Datën e dorëzimit të raportit dhe
  - l. Nënshkrimet e zyrtarëve kompetent

4. Raporti printohet në dy kopje, një të mban profesori i lëndës dhe tjetër të dorëzohet në administratë. Raporti i dorëzuar në administratë duhet të nënshkruhet edhe nga personat e paraparë në paragrafin 2 të këtij neni.
5. Raporti konsiderohet i vlefshëm vetëm nëse përmban të gjitha të dhënat e specifikuar dhe është nënshkruar nga të gjithë personat kompetent.

#### **Neni 4**

1. Lista e studentëve të paraqitur në provim përmban shënime kryesisht rreth rezultatit të studentëve të arritur në provim dhe në vlerësimet paraprake.
2. Lista e studentëve të paraqitur në provime duhet të përmbajë këto shënime:
  - a. Fakultetin
  - b. Emërtimin e lëndës
  - c. Statusin e lëndës (obligative, zgjedhore, opcionale)
  - d. Afatin e provimit
  - e. Emrin dhe mbiemrin e mësuesit
  - f. Datën e provimit
  - g. Gjeneratën e regjistrimit të studentit
  - h. Emrin dhe mbiemrin e studentit
  - i. Numrin identifikues (dosjes apo indeksit)
  - j. Statusin
  - k. Vlerësimet e ndërmjetme
  - l. Numrin e pikëve të arritura në testin final dhe
  - m. Nota përfundimtare
3. Lista e studentëve të paraqitur në provim printohet në dy kopje dhe i bashkëngjitet Raportit mbi rezultatet e vlerësimit të studentëve.
4. Lista e studentëve të paraqitur në provim nënshkruhet vetëm nga profesori i lëndës dhe obligohet që të nënshkruhet në secilën faqe.

#### **Neni 5**

Asistenti administrativ i fakultetit detyrohet që mos ta pranojë Raportin mbi rezultatet e vlerësimit të studentëve nëse nuk është plotësuar sipas kërkesave dhe Listën e studentëve të paraqitur në provim nëse nuk i përmban shënimet e kërkuara dhe nëse nuk është nënshkruar në secilën faqe.

#### **Neni 6**

Të dy raportet gjenerohen nga sistemi për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe nuk lejohet asnjë ndërhyrje pa lejen e Dekanit të Fakultetit dhe pëlqimin e Prorektorit për mësim dhe çështje akademike.

#### **Neni 7**

Në rast se raporti i printuar nuk është identik me të dhënat në sistem, atëherë vlen raporti i dorëzuar në administratë dhe i nënshkruar nga të gjithë personat kompetent.

### Neni 8


Çështje tjera që kanë të bëjnë me afatet e dorëzimeve, format e vlerësimit, etj, rregullohen me rregullore të veçanta.

### Neni 9

Me nënshkrimin e kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregulloja e vitit 2007 për Raportin mbi Rezultatet e provimit.

### Neni 10

Pjesë përbërëse e kësaj rregullore është edhe aneksi 1, i cili do të shërbejë edhe si mostër e Raporti mbi rezultatet e vlerësimit të studentëve dhe Listës së studentëve të paraqitur në provim.

  
Prof. dr. Lulzim Tafa, Kryetar i Këshillit Drejtues




## RAPORTI MBI REZULTATET E VLERËSIMIT TË STUDENTËVE

<b>Fakulteti:</b>	
<b>Programi:</b>	
<b>Afati i provimeve:</b>	
<b>Viti akademik:</b>	
<b>Data e mbajtjes së provimeve:</b>	
<b>Lënda:</b>	
<b>Mësimdhënësi:</b>	
<b>Viti i studime/semestri:</b>	
<b>ECTS:</b>	

Vlerësimi										
Gjenerata	Gjithsej të paraqitur	Abstenime	5	6	7	8	9	10	Kaluan %	Nuk kaluan %

<b>Data e dorëzimit të raportit:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	
<b>Dekani i fakultetit:</b>	
<b>Asistenti/ja administrative e fakultetit:</b>	



Vulosez nga administrata

## LISTA E STUDENTËVE TË PARAQITUR PËR PROVIM

<b>Fakulteti:</b>	
<b>Lënda:</b>	
<b>Statusi: Obligative, Zgjedhore, Opcionale</b>	
<b>Afati i provimeve:</b>	
<b>Mësimdhënësi:</b>	
<b>Data e provimit:</b>	

Nr.	Gjenerata	Studenti	Nr. i dosjes	Statusi	Pjesëmarrja %	Vlerësimet	Testi final	Nota përfundimtare
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								

Raporti duhet të nënshkruhet në secilën faqe nga mësimdhënësi i lëndës dhe duhet të dorëzohet në administratë



# Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale  
Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës,  
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797  
Mail: [info@aab-edu.net](mailto:info@aab-edu.net);  
[www.aab-edu.net](http://www.aab-edu.net)

Ref. nr. 281/2021 Prishtinë, 20.05.2021

Këshilli Drejtues i Kolegjit AAB mori këtë:


## V E N D I M

1. MIRATOHET Rregullorja për raportin mbi rezultatet e provimit
2. MIRATOHET Formati i raportit mbi rezultatet e vlerësimit të studentëve
3. MIRATOHET Formati i listës së studentëve të paraqitur për provim

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Prorektorëve
2. Sekretarit
3. Dekanëve



  
Dr. sc. Lulzim Tafa  
Kryetar i Këshillit Drejtues